



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

### Termt e Referencës

<b>Pozicioni:</b>	Ekspert lokal
<b>Vendodhja:</b>	Shqipëri
<b>Fillimi i Punës:</b>	19.06.2021
<b>Mbarimi i Punës:</b>	29.06.2021
<b>Kohëzgjatja:</b>	5 ditë punë

### Projekti

Ditët e sotme burgjet janë mjedise multi-etnike. Diversiteti etnik dhe kulturor i të burgosurve paraqet sfida të shumëfishta për stafin e vijës së parë në burgje, të cilët përballen më kultura e gjuhë të “panjohura”, fenomenin e nën-kulturës dhe episode të mundshme radikalizimi dhe ekstremizmi. Menaxhimi i aspekteve multi-kulturore në ambientet e burgjeve është një çështje prioritare në legjislacionin e BE-së, siç theksohet edhe në Rekomandimin Cm/ Rec (2012)12 të Këshillit të Ministrave. Nisur nga kjo ka lindur nevoja që stafi i burgjeve të marrë trajnimet e duhura për tu përballur me nevojat dhe të drejtat e të burgosurve të huaj. Në këtë kuadër, projekti 2 vjeçar “B-ComPetent – Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” ka për qëllim të kontribuojë në aplikimin koherent dhe efektiv të legjislacionit dhe standardeve të BE lidhur me trajtimin e të burgosurve të huaj nëpërmjet ndërtimit dhe implementimit të një programi të tipit “train-the-trainers” (ballë-për-ballë dhe e-learning), kombinuar me praktikën më të mira, aksione për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore. Avokati i Popullit në bashkëpunim me gjashtë partner, janë duke implementuar projektin nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*” i bashkë financuar nga Programi i Drejtësisë së BE (2014-2020).

## **Objektivi**

Avokati i Popullit kërkon të rekrutojë një Ekspert Lokal, i cili do të angazhohet në hartimin e një artikulli shkencor i cili do të publikohet në revista shkencore brenda ose/dhe jashtë vendit, si dhe në faqen zyrtare <https://www.bcompetent.eu/> e rrjetet sociale <https://www.facebook.com/bcompetent/> të manaxhuara nga stafi i projektit nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*”.

## **Detyrat dhe përgjegjësitë**

Avokati i Popullit do të kërkojë kryerjen e shërbimit nga një Ekspert Lokal, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e një artikulli shkencor. Artikulli do të fokusohet mbi statusin dhe nevojat e veçanta që kanë shtetasit e huaj në burgje, si dhe politikat e përshtatshme që duhen ndërmarrë, duke qënë se lind nevoja për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave të të burgosurve të huaj, sipas Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky artikull, i cili do të publikohet nën emrin e institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të projektit B-COMPETENT, duhet të jap udhëzime dhe rekomandime që synojnë përforcimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe legjislationit të sapo-miratur të burgjeve në Shqipëri.

## **Kriteret e veçanta**

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat juridike
- Të ketë eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, sidomos të burgosurit e huaj.
- Vlerësohet nëse eksperti ka pasur bashkëpunime të tjera të mëparshme me institucionin e Avokatit të Popullit.
- Vlerësohet që eksperti të ketë kryer hulumtime shkencore dhe të ketë pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare, si dhe të ketë kryer botime shkencore brenda e jashtë vendit.
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial.

## **Aplikanti duhet të dorëzoj:**

1. Letër motivimi
2. Curriculum vitae
3. Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

**Afati i aplikimit:** 07 Qershor 2021

**E-mail:** [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

**Adresa:** Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 2, Tiranë